



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.4092/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-048 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2022/01 me Nr. 797/2021 e datës 14.05.2021, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.06.2021 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2022-2024

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024 e cila përmban planifikimet buxhetore nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 është në lartësi prej **2,759,758 €**, ndërsa projeksionet për vitin 2023 janë në shumë prej **2,903,855 €** dhe për vitin 2024 janë në shumë prej **3,039,398 €**.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2022 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga financimi qeveritar (granti i përgjithshëm, granti i arsimit dhe i shëndetësisë) janë në shumë prej 2,378,411 €, që shënojnë pjesëmarrje në shumë prej 86.18%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 381,347 € apo 13.82%.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe shtesa 1,756,083 €, Mallra dhe shërbime 385,975 €, Shpenzime Komunale 67,700 €, Subvencione dhe transfere 80,000 € dhe Shpenzime kapitale 470,000 €.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Ky vendim iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorëve të drejtorive,
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Departamentit të Buxhetit,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data: 29. 06. 2021

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava